



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:183728
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05801529

Cap.nr.1594/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, nga gjyqtarja individuale Naime Ahmeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit H.H. nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.K., avokat nga Prishtina, ndaj debitorës Qeveria e Kosovës-Ministria e Financave, Punës e Transfereve-Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Rinor Arifi, me bazë juridike zbatim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.848/2021 të datës 09.08.2023, me datë 10.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e të autorizuarit të kreditorit H.H. nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, Cpc.nr.848/21 i datës 09.08.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.848/21 të datës 09.08.2023, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Qeveria e Kosovës-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, ashtu që ka shfuqizuar pjesërisht aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.484/2021 të datës 08.03.2023, dhe atë në pikën I të dispozitivit me të cilin e ka caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit të përmbartueshëm-Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, A.nr.484/2032 i datës 18.06.2021, duke e detyruar debitorën Qeveria e Kosovës-Ministria e Financave, Punës e Transfereve-Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që kreditorin ta sistemoj në njërin nga pozitat e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe ka refuzuar si të pabazuar propozimin për përmbartim të kreditorit H.H. i datës 10.08.2021, përkitazi me kërkesën për kthimin në vendin e punës me të

cilën ka punuar para largimit të kundërligjshëm, me të gjitha të drejtat dhe kompetencat në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë të aprovoj ankesën e kreditorit si të bazuar, të anuloj aktvendimin e atakuar Cpc.nr.848/21 të datës 09.08.2023, apo lënda ti kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorës në bazë të dokumentit përmbarues-vendimit administrativ të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, A.nr.484/2021 të datës 18.06.2021, lidhur me kthimin në punë dhe kompensimin e diferencës në pagë në pjesën e humbur nga data 13.06.2019. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin Cpc.nr.848/21 të datës 08.03.2023, ka lejuar pjesërisht përmbarimin vetëm sa i përket kthimit në punë të kreditorit ndërsa ka refuzuar propozimin për përmbarim lidhur me kompensimin e diferencës ë pagës. Ndaj këtij aktvendimi i autorizuari i debitorit ka paraqitur prapësim me datën 18.04.2023, ndërsa kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 12.05.2023. Gjykata e shkallës së parë, lidhur me prapësimin e paraqitur ka mbajtur seancë dëgjimore me datën 01.08.2023 dhe se pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim vendosi si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Në bazë të nenit 21 të LPP-së, organi përmbarues e cakton përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm. Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për ekzekutim, në bazë të dokumentit përmbarues, gjykata si organ përmbarues e cakton përmbarimin vetëm në bazë të titullit përmbarues siç është në rastin konkret vendimi administrativ i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.196/2021 të datës 26.04.2021. Dokument përmbarues në bazë të nenit 22, pika 1.2 të LPP-së, është: *“vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktapajtimi*

(ujdia)". Po ashtu, në bazë të nenit 23 paragrafi 2, të LPP-së është përcaktuar se: *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike, kurse aktapajtim administrative konsiderohet ujdia e arritur në procedurën administrative përpara organit ose shërbimit, përkatësisht personit juridik të tillë, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër”,* e që në rastin konkret kemi të bëjmë me aktvendim administrativ siç përcaktohet me dispozita ligjore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndron pretendimi ankimor se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurë përmbartimore dhe kontestimore dhe se dispozitivi është i paqartë dhe kundërthënës me arsyetimin. Aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivi i aktvendimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktvendimit. Në arsyetim të aktvendimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me aprovimin e prapësimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të kreditorit se të njëjtit nuk i është mundësuar ushtrimi i detyrave të punës si zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës e madje as sipas vendimit nr.11/183 të datës 09.07.2021, të nxjerr nga debitori. Gjykata ankimore me shikim në shkresë e lëndë gjen se në rastin konkret debitori në mënyrë vullnetare ka përmbushur detyrimin sipas vendimit nr.183 të datës 09.07.2021, duke e sistemuar kreditorin në pozitën Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Programe dhe Procedura, duke vepruar konform vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, A.nr.484/2021 të datës 18.06.2021, dhe se në rastin konkret është në diskrecionin e punëdhënësit-këtu debitorit lidhur me caktimin e detyrave dhe përgjegjësi të punëtorit.

Lidhur me pretendimin ankimor se rekomandimi për sistemimin e kreditorit duke i bazuar në vendimin nr.1906 të datës 09.12.2022 si dhe aktelimin AE.nr.12/2022 është në kundërshtim me nenin 54 të Ligjit për Zyrtarët Publikë si dhe nenit 13 të Rregullores për Transferimin e Nëpunësve Civil, pasi që transferimi nuk është bërë brenda të njëjtës kategori d.m.th. kreditori është transferuar nga kategoria e lartë drejtuese në kategorinë e mesme drejtuese, Gjykata e Apelit vlerëson se është pretendim i pabazuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se vendimi nr.1906 i datës 09.12.2022 si dhe akt emërimi AE.nr.12/2022, nuk janë objekt shqyrtimi në këtë çështje pasi në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktojë dhe zbatojë përmbartimin. Në rastin konkret, në dokumentin përmbartues (titullin ekzekutiv), vendimit administrativ i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, A.nr.484/2021 të datës 18.06.2021, në pikën III të këtij vendimi është obliguar debitori që kreditorin ta sistemojë në njërin nga pozitat e Drejtorit të Përgjithshëm, pozitë të cilën kreditori e ka mbajtur, ndërsa me vendimin e debitorit nr.11/183 të datës 09.07.2021, kreditori

është sistemuar në pozitën Zëvendës i Drejtorit të Përgjithshëm për Programe dhe Procedura, pozitë ekuivalente me pozitën që ka mbajtur deri me datën 13.06.2019.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË
Cap.nr.1594/2023, më datë 10.06.2024

Gjyqtarja
Naime Ahmeti